



Menaxhimi i projektit dhe studimin e mjedisit për Projektin “ Mullinj me Erë” - Në Qarkun Korçë (PROJEKTI KAPPET)

Konteksti i projektit

Në përpjekjet e tij drejt mbrojtjes së mjedisit, IKU ka studiuar burimet potenciale të energjive të rinovueshme, të cilat janë duke u shpërndarë në mbarë botën me shpejtësi. Përpjekjet dhe investimet e bëra nga shumica e shteteve të botës janë në drejtim të implementimit të Protokollit të Kiotos. Respektimi i këtij protokollit do të intensivikojë përpjekjet për të gjetur dhe përdorur burime të reja energjie që kanë efikasitet dhe njëkohësisht kanë një impakt shumë të vogël në mjedis për të mos thënë impakt “zero”. URI është një OJQ pionier që filloi me nismën e ngritjes në Shqipëri të një parku energjetik, që shfrytëzon energjinë e erës. Krahasuar me efektet në mjedis të burimeve të energjisë tradicionale, efektet mjedisore të energjisë së erës janë relativisht të vogla. Fuqia e erës nuk konsumon karburant, dhe nuk prodhon ajër të ndotur, në dallim nga burimet e energjisë të prodhuar nga mbetjet. Energjia e konsumuar për të prodhuar dhe transportuar materialet për të ndërtuar një central të energjisë së erës është e barabartë me energjinë e re e prodhuar nga centrali, vetëm brenda disa muajsh nga fillimi i operacionit.

Synimet Kryesore:

➤ Synimi i projektit KAPPET, të menaxhuar nga IKU është vënia në shfrytëzim e Centralit me erë për prodhimin industrial të energjisë elektrike, duke shfrytëzuar lëvizjen e ajrit (energjinë e erës). Ky park është konceptuar dhe projektuar i përberë nga 87 aerogjeneratorë. Parku i erës do të zhvillohet në dy zona të veçanta,



nënprojektet janë quajtur "Petrushë" në komunat Vreshtaz dhe Çerave dhe një "Kapshticë" në komunën e Bilishtit.

- Projektit KAPPET do të kontribuojë në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë për nxitjen e teknologjisë së pastër dhe reduktimin e gazeve ndotës të efektit serrë të emetuar në atmosferë siç synohet nga protokollit i Kiotos, duke zvogëluar sasinë e CO2 me 303 milion kg në vit.
- Projektit KAPPET do të sjellë reduktimin e presionit mbi pyjet, etj. Projekti do të ketë ndikim pozitiv në uljen e ritmeve të erozionit të zonës, përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, në përmirësimin e gjendjes së zonave të mbrojtura etj.
- Projekti KAPPET mbështet në mënyrë të drejtpërdrejtë përmbushjen e 4 nga 7 synimet themelore të strategjisë kombëtare të energjisë (SKE). Në

përputhje me veçoritë fiziko-geografike të zonës, numrit dhe tipologjisë së aerogjeneratorëve dhe konfiguracionit gjeometrik të instalimit të tyre në territor është vlerësuar që prodhimi vjetor i Centralit me erë “KAPPET do të jetë jo më pak se 383.000 MWh/vit. Vija e kufirit të jashtëm të zonës së studiuar që zë një sipërfaqe prej 4 125 ha, ku do të ndërtohen mullinj të me erë i korrespondon një niveli minimal akustik, studiuar dhe vlerësuar të jetë në nivelin e 40 db. IKU ka menaxhuar aktivitetet e projektit, disa studime, ku më i rëndësishmi ka qenë studimi mjedisor.

FAKTET KRYESORË

PËRFITUESIT:

- ✓ Qarku Korçë

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.